



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT/ TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI/
PROCUREMENT REVIEW BODY**

PSH.Nr.524/16

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: z. Ekrem Salihu – Kryetar, z.Blerim Dina- Referues, z. Tefik Sylejmani – Anëtar, si dhe duke u bazuar në nenin 99 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092 dhe konform nenit 39 të Rregullores së punës së OSHP-së nr. 02/2015, pas shqyrtimit të kërkesës së autoritetit kontraktues - /Policia e Kosovës/, që OSHP-ja të veproj konform nenit 99 të LPP-së, përkitazi me OE “Kapital X Shpk”-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shërbime Projektimi”, me nr.prok:”214/16/060/221”, më 19 Janar 2016, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Refuzohet**, si e pa bazuar, kërkesa e Autoriteti Kontraktues (AK) – /Policia e Kosovës/ e dt: 06.06.2016, për diskualifikim të operatorit ekonomik “Kapital X Shpk”- Prishtinë, nga pjesëmarrja në prokurim publik, përkitazi me aktivitetin e prokurimit “Shërbime Projektimi”, me nr.prok:”214/16/060/221” .

ARSYETIM

Autoriteti kontraktues /Policia e Kosovës/, me dt:06.06.2016 ka parashtruar kërkesë, në OSHP, që të shqyrtohet mundësia e veprimit konform nenit 99 të LPP-së, për diskualifikim të OE “Kapital X Shpk”.Prishtinë.

Lidhur me kërkesën e lartpërmendur, OSHP-ja ka caktuar seancë dëgjimore me dt:19.01.2016, ku përveç Panelit shqyrtues, kanë marrë pjesë, përfaqësuesi i Policisë së Kosovës dhe përfaqësuesi i Operatorit Ekonomik “Kapital X Shpk”.

Gjatë prezantimit në seancën dëgjimore, përfaqësuesi i AK- Policia e Kosovës z.Sejdi Halimaj deklaroj ‘Është e vërtetë se ne si AK kemi bërë kërkesë me këto pretendime që besoj se i kemi konstatuar. Për momentin kërkoj falje se ndoshta dokumentet në fjalë nuk i kam me vete, mirëpo ato gjinden në dosje dhe mund të bëjmë një krahasim praktik në prani të panelit shqyrtues. Si provë materiale kemi dokumentin nga ATK me numër fiskal si tatim pagues dhe numrat që ka sjell OE në fjalë nuk kanë korresponduar me numrat në dokumentin e ATK-së. Numri fiskal 600906684, këtu tani kemi numër 70913712, dhe më vonë numër 1801301, dhe numrat në dokumentet në ofertë të OE dallojnë me numrat që kemi marrë në dokumentet e ATK-së. Certifikata e regjistrimit, pretendimi ynë për falsifikim është se, numrat fiskal nuk korrespondojnë, sa i përket inxhinierit z.Nusret Nasufi, në referencën e ofruar nga OE bëhet fjalë për Nusret Nasuf-in në emailen e dërguar inxhinier kryesor është Valdet Xoxa’.

Gjatë prezantimit në seancën dëgjimore përfaqësuesi i OE ‘Kapital X Shpk’ z.Valdet Xoxa deklaroj: ‘Ne nuk kemi ditur se për çka po vijmë sot në seancë dhe nuk kemi ditur agjendën. Certifikata e lëshuar prej ATK-së, dokumenti që i referohet AK-së është dokument elektronik që e menaxhon ATK, ata kanë pas telashe në sistem të vet, unë ATK-së në atë kohe ju kam drejtuar dhe kam kërkuar të përmirësojë këtë gabim elektronik në sistem të tyre. ATK më vonë kanë bërë përmirësimin, dhe kemi kërkuar të na lëshojnë dokument se kjo ka zënë vend kur ne kemi humbur një kontratë pranë AK-së për shkak të gabimit elektronik të ATK-së. Ata me janë drejtuar se Autoriteti i Policisë ka të drejtë të kërkojë këtë sqarim e jo ne, pasi të kenë marrë një vendim duke u bazuar në një dokument të tillë.

Dokumenti për të cilin policia e Kosovës pretendon nuk është falsifikim dhe ka qenë gabim i ATK-së. Për këtë që nga vitit 2015 kemi bërë kërkesë prej ATK-së. Mënyra e vërtetimit të dokumenteve siç bënë Policia e Kosovës është jo ligjore, pasi nuk përmbajnë as vulë as nënshkrim etj. Ne nuk kemi asnjë borxh pranë ATK-së dhe këtë OSHP mund të vërtetojë shume lehtë. Pretendimi i AK-së për inxhinier, kompania ime ka të drejtë ti lëshojë referencë inxhinierëve të vet dhe kam të drejtë ti lëshojë reference edhe vetes, dhe thënë drejtë nuk po e kuptojë logjiken e AK-së kur pretendon për falsifikim të dokumenteve. Si unë ashtu edhe inxhinieri në fjalë kanë qenë pjesë e projektit për të cilën ka pas referencën.

Anëtari i panelit shqyrtues z. Sylejmani, pyeti përfaqësuesin e AK-së, se pas marrjes së këtij dokumenti të ATK-së, pasi keni parë mospërputhjet, a i jeni drejtuar ATK-së për sqarim?

Në përgjigje përfaqësuesi i AK deklaroj: Ne i kemi besuar dokumenteve të ATK-së dhe nuk e kemi pa të arsyeshme të hulumtojmë më tutje.

Lidhur me pretendimin e AK-së se operatori ekonomik “Kapital X Shpk” ka ofruar të falsifikuar certifikatën e TVSH-së, paneli shqyrtues konstaton se certifikata në fjalë është

dokument publik dhe se ATK-ja ka bërë gabim teknik, e të cilin më pastaj e ka përmirësuar pas reagimit të operatorit ekonomik “Kapital X Shpk” se është një gabim teknik në numrin fiskal tek certifikata e TVSH-së, prandaj ky pretendim është i paqëndrueshëm dhe i pa bazuar. Gjithashtu edhe në seancë u vërtetua dhe u pranua nga vetë përfaqësuesi i AK-së, se autoriteti kontraktues nuk ka kërkuar sqarime për të vërtetuar certifikatën, pasi që sipas tyre ju kanë besuar shkresave të ATK-së.

Lidhur me pretendimin e AK-së se operatori ekonomik “Kapital X Shpk” ka ofruar të falsifikuar referencën në lidhje me inxhinierin e arkitekturës, paneli shqyrtues konstaton se kompania “Kapital X” i ka lëshuar reference pronarit dhe inxhinierit, të cilët kanë qenë pjesë e projektit për të cilën është bashkëngjitur referenca, e i cili veprim nuk është kundërligjor, pasi që është e drejtë e OE. të lëshojë referencë për secilin punëtorë dhe gjithashtu edhe për pronarin e kompanisë nëse merr pjesë në ndonjë projekt, prandaj edhe ky pretendim i AK-së është i paqëndrueshëm, pasi që nuk ka asnjë asnjë dëshmi dhe asnjë fakt për ndonjë falsifikim të dokumenteve të lartpërmendura.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në të gjitha dëshmitë e prezantuar nga palët në procedurë, prezantimeve në seancën dëgjimore, pas shoshitjes së të gjitha provave konstaton se kërkesa e autoritetit kontraktues për diskualifikim të operatorit ekonomik “Kapital X Shpk” është e pabazuar dhe nuk është e mbështetur në asnjë provë materiale.

Paneli shqyrtues, nga të cekurat më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur nuk mund të ushtron ankesë, por për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh, pas pranimit të këtij vendimi, me kërkesë-padi mund ti drejtohet. Departamentit për çështje Administrative, në Gjykatën themelore në Prishtinë.

Kryetari i Panelit Shqyrtues
Z. Ekrem SAJFIU



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – “Policia e Kosovës”

1x1 OE - “Kapital X Shpk” -Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në Web- faqe të OSHP-së.